

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË KONTRATËS

1. PËRKUFIZIME

Garantuesi: Shoqëria e Sigurimeve "ANSIG" Sh.A;

Kontraktuesi: Subjekti, që nënshkruan Kontratën e Sigurimit të Garancisë.

Përfituesi: Enti Prokurues (interesi pasuror i të cilit sigurohet nga "Çertifikatën e Garancisë së Kontratës".

2. OBJEKTI I KONTRATËS

2.1. Garantuesi i detyrohet Përfituesi deri në shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë nëse Kontraktuesi, fitues në tender:

2.1.1. Nuk plotëson detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata me Përfituesin;

2.1.2. Ndërpret zbatimin e kontratës para afatit të përfundim të saj.

3. PERIUDHA E GARANCISË

Periudha e mbulimit do të jetë :

3.1. Data e fillimit, brenda afatit të parashikuar Enti Prokurues (jo më vonë se dita e përcaktuar për lidhjen e kontratës.

3.2. Data e mbarimit është dita kur përfundon afati i kontratës;

3.3. Vlefshmëria e kontratës fillon në afatet e përcaktuara nga Njësia e Prokurimit për lidhjen e kontratës.

4. PRIMI I SIGURIMIT

4.1. Primi i sigurimit llogaritet nga Garantuesi sipas "Sistemit tarifor për kontratat e garantimit të ofertës dhe kontratës";

4.2. Pagesa e primit do të kryhet njëkohësisht me lidhjen e kësaj kontrate.

5. SHUMA E SIGURIMIT

5.1. Garantuesi i detyrohet Përfituesit deri në shumën e sigurimit të përcaktuar në këtë kontratë.

6. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT

6.1. Përfituesi duhet të njoftojë Garantuesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit.

6.2. Në rast se Përfituesi nuk respekton afatin, Garantuesi ka të drejtë për pagimin ose jo të dëmshpërblimit.

7. DËMSHPËRBLIMI

7.1. Garantuesi, do të paguajë për çdo kërkesë me shkrim të Përfituesit, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, deri në shumën e sigurimit të përcaktuar në të.

7.2. Pagesa do të kryhet brenda një periudhe 15 ditore, pas kërkesës me shkrim të Përfituesit, përfaqësuesit të autorizuar dhe kur të jetë plotësuar kushti sipas nenit 3 të kësaj kontrate.

8. DETYRIME TË PALËVE

Garantuesi ka detyrimin:

8.1. Të paguaj për llogari të Përfituesit çdo dëm kur është vërtetuar që ka ndodhur për faj të Kontraktuesit.

8.2. Kontraktuesi ka detyrimin të përfundojë kontratën e sipërmarrjes ose ndonjë detyrim kontraktual i cili është i garantuar nga "Çertifikata e Garancisë së Kontratës".

9. ZGJIDHJA E KONTRATËS

9.1. Kontrata e Garancisë mund të anulohet, duke ia kthyer atë Garantuesit sëbashku me Çertifikatën e Garancisë së Kontratës.

9.2. Në rastin e anulimit të "Çertifikatës së Garancisë së Kontratës", Garantuesit i lind e drejta të mbajë Kontraktuesit shpenzimet administrative në masën deri në 20 % të primit të arkëtuar.

9.3. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis Garantuesit dhe Përfituesit, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

SIGURUESI

KONTRAKTUESI